



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **64**

Prishtinë, më 9.2.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Hestet Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Dragiša Mirić, Zef morina, Selvie Halimi, Myrvete Pantina.

Mungoi : Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Ministri i Mjedisit dhe i Bujqësisë, zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Visar Krasniqi .

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 26.1.2010,
3. Ministri i Bujqësisë dhe i Mjedisit për raportin e progresit dhe strategjinë legjislative,
4. Vërejtjet e komisionit për Buxhet në dy projektligje,
5. Matrica e mbikëqyrjes së ligjeve

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** dhe për disa çështje tjera, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 26.1.2010

Naser Rugova-kryetar kërkoi ndërhyrje në deklarinimin e tij në mbledhjen e fundit i cili duhet të jetë si vijon :

“Naser Rugova ceku se ka biseduar rreth mundësisë së identifikimit të ekspertëve të lëmive brenda ambientit, përkrahur nga UNDP, SOROS dhe KFOS të cilët mund të japin këshilla-mendime. Objektivat duhet të jenë shumë specifike që të mos sjellin paqartësi në punën hulumtuese në ndonjë projekt, ndaj sugjeroi që duhet të saktësohen qartë kërkesat e komisionit për ekspertë. Parashihet që kërkesa të dërgohet sa më parë dhe të përfshihet në tremujorin e parë. Gjithashtu u diskutua për 6 mujorin e parë të

futet në agjendë hartimi i ligjeve cilësore, poçes komisioni evropian aprovon kërkesën për ekspertë të lëmisë përkatëse. Kjo do të ndikojë në ngritjen e cilësisë evropiane të ligjeve (shembull e ceku paqartësitë gjatë shqyrtimit të projektligjit për pyje), sidomos duhet të publikohet për media puna e këtij komisioni ngase shpesh figuron një projekt që nuk është përfunduar në këtë komision, ndërsa në fakt shkaqet janë në mospunën e komisioneve tjera, ngase ky komision i kryen punët me rregull dhe ekzakt (shembull mori projektligjin për shitjen e banesave). Ai konstatoi si përfundim personal : ekspertët duhet të japin mendimin p.sh. për 6 projektligje për të cilat edhe do të financohet.”

Në vazhdim konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 26.1.2010.

3. Ministri i bujqësisë dhe i mjedisit për raportin e progresit dhe strategjinë legislative

Kryetari Naser Rugova falënderoi për pjesëmarrjen e dy ministrave dhe kërkoi sqarimet për temat e kërkuara për çka **Mahir Yagcillar** tha se sfidat e parapara nga komisioni evropian janë përmbushur shumica nga MMPH përveç disa ngecjeve që kjo ministri konsideron se janë të arsyeshme për shkak të vështirësive të natyrës së ndryshme. Për pikën 51 (vendbanimet joformale) është paraparë plani i veprimit dhe masat për integrimin e tyre. Plani parasheh fillimisht identifikimin e tyre pastaj zbatimin e masave për parandalimin e tyre me anë të programeve sociale për banim. Pika 53, vazhdoi ai, është pasojë e pakos së Ahtisarit (për Hoçën dhe zonat tjera të veçanta) për të cilat MMPH është në vazhdimësi në kontakt me përfaqësuesin special por ai tha se nuk mjafton vetëm angazhimi i ministrisë pa u bashkëngjitur edhe ana tjetër (përfaqësuesit e kishave etj), gjithashtu ceku se Ligji për Prizrenin do të procedohet shpejt sipas standardeve evropiane. Pika 79 flet për mbrojtjen e ajrit për çka është projektligji në procedurën parlamentare, ndërsa pika 80 (zogjtë e egër) është transferuar tek pika e Ligjit për mbrojtjen e natyrës i cili projekt gjithashtu do të procedohet në parlament. Pika 81 që ka të bëjë me ndotje industriale, ministri tha se ligji është në zbatim e sipër dhe lejet e para integruese mjedisore (IPPC) do të aplikohen që tani. Për themelimin e Bordit mjedisor (pika 82) tha se puna do të përfundojë në mars. Pika 85 rreth sfidës nukleare dhe rrezatimit jonizues do të miratohet të enjten ligji përkatës në seancën plenare. Për strategjinë legislative 2010 tha se janë paraparë ligje mjaft të rëndësishme por edhe sfiduese, ngase parashihet të themelohet fondi mjedisor. Nëse miratohet ligji për mbrojtjen e natyrës ai parasheh që parqet nacionale do të përfundojnë shpejt dhe atë veç e veç. **Zef Morina** ndërhyri dhe kërkoi që Ligji për ndërtimet duhet të ketë prioritet ngase trajtimi i ndërtimeve pa leje nuk ka efekt poçes nuk kemi ligj të ndërtimit. Këtë e miratoi ministri dhe sqaroi arsyet për ngecje të gjertanishme, në fakt MTI e ka një departament për ndërtime, ndaj kjo ka qenë arsye për disa komplikime, mirëpo tani të tejkaluara.

Naser Rugova tha se ky komision në planin e miratuar për këtë vit ka paraparë një agjendë dinamike dhe bashkëpunim të ngushtë me dy ministratë për çka kërkoi kontribut të dyanshëm. Ai vazhdoi me disa sugjerime tjera siç janë respektimi i datave për projektligje në strategji ngase deri në fund të marsit nuk parashihet arritje të ndonjë projektligji, sidomos agjencia evropiane të jetë në top agjendën e dy institucioneve (komisionit dhe MMPH). Është e qartë , vazhdoi, se do të na përcjellin problemet serioze (vendbanimet joformale) por ajo çka kërkohet ne do të ofrojmë baza ligjore dhe vullnet, të tjerat varen nga subjektet tjera. Duhet të pranohet se Pakoja e Ahtisarit paraqet problem politik, ndaj duhet të flitet pa dorëza dhe të adresohen problemet tek ndërkombëtarët (si p.sh. projektligji për banesat që vonohet këtu në Kuvend pa kurrfarë faji të këtij komisioni). **Në fund në emër të komisionit kërkoi që sqarimet që u dhanë në mbledhjen e sotme, dhe ato që do të jepen nga ministri i bujqësisë, të dërgohen me shkrim në fund të marsit dhe kështu të vazhdoi çdo tre muaj, në mënyrë që të procedohen më tutje komisionit evropian.**

Berat Luzha konstatoi se ky komision ka monitorua Ligjin për mbeturina ku ka pasur mjaft probleme në terren, ndaj kërkoi hartimin e një ligji të ri para shtatorit ngase atëherë është

shumë vonë, gjithashtu **Naim Maloku** mbështeti këtë kërkesë dhe kërkoi sqarime shtesë nga MMPH çka kanë ndërmarr në lidhje me rekomandimet e këtij komisioni përkatësisht të seancës plenare, ngase mbeturinat kërkojnë një trajtim shumë më serioz për shkak të kolapsit. Për disa projektligje në strategji tha se duhet të procedohen prej 1 shtatori ngase do të mbesin për vitin e ardhshëm dhe MMPH duhet të ketë kujdes për afate të propozuara dhe t'ju përmbahet atyre.

Elheme Hetemi shprehu mirëkuptim kur është në pyetje puna e dy ministrive (problemet e kuadrove etj) por kërkoi mospërsëritjen e gabimeve të mëparshme. Lidhur me mbeturinat kërkoi sqarim rreth deponisë së Gjilanit e cila paraqet rrezik, për çka ministri premtoi angazhim maksimal për defekt teknik që mbretëron atje.

Heset Cakolli gjithashtu shfaqti optimizmin se MMPH do t'ju përmbahet datave të cekura në strategjinë legjislativë 2010 ngase disa nga këto projektligje kanë qenë të parapara edhe në tremujorin e parë të vitit 2009 dhe sugjeroi që kjo ministri të përgatit raportin për rekomandimet rreth monitorimit të Ligjit për Mbeturina nga ana e këtij komisioni me çka do të kontribuohet tejkalimi i gjendjes në terren, pra viti 2010 të jetë vit i kthesave pozitive.

Myrvete Pantina gjithashtu kërkoi respektimin e afateve të dhëna për hartimin e projekteve për shkak të zbrazëtive në agjendën e punës së komisionit për çka nuk do të mungoi angazhimi i komisionit.

Zef Morina përsëriti kërkesën rreth ligjit për ndërtimet që sa më shpejt të hartohet ndërsa për një projekt (për Hoqën) shprehu mos kuptim, ndërhyri **Naser Rugova** duke sqaruar se kemi të bëjmë me “ligje politike” për zonat e veçanta për çka edhe arsyetoi apelin e tij që të flitet sa më tepër me transparencë dhe pa dorëza, së paku të tregohen barrierat duke bërë prerjet e duhura.

Mahir Yagcillar pranoi se disa projekte janë përcjellë në këtë vit por tanimë janë tejkaluar disa probleme (p.sh. problemet me MTI rreth Ligjit për Ndërtimet etj). Për ligjin e Mbeturinave tha se komisioni do të informohet shumë shpejt, ndërsa hartimi i ligjit të ri ka filluar pikërisht në bazë të rekomandimeve të komisionit.

Ministri **Idriz Vehapi** gjithashtu njoftoi komisionin për hapat e ndërmarr në ministrinë e bujqësisë, fillimisht për raportin e progresit në bujqësi e peshkatari. Ligji për bujqësinë organike shpejt do të amendohet me harmonizime të BE dhe është në fazën e fundit, do të themelohen njësit e duhura, Ligji për verëra gjithashtu është në përfundim (tremujori dytë) bashkë me disa udhëzime që tanimë janë miratuar (i saktësoi edhe me data), Ligji për pyje është paraparë në fund ngase në ministri është menduar se projekti për ndryshime do të kryhet deri tani, megjithatë ai premtoi se shpejt do të hartohet duke potencuar se faji qëndron te problemet e ndjekjes (gjyqësia dhe problemet me kryesit recidivistë) e jo në ministri, ngase ministria identifikon problemet (**Elhame Hetemi** u pajtua se problem nuk është ligji). Reagoi edhe **Berat Luzha** i cili tha se hartimi i një ligji megjithatë paraqet një domosdoshmëri për shkak të rrethanave ekzistuese. Sfidë tjetër (vazhdoi ministri) është sektori i tokave vështirë e kalueshme ngase ka ngecje në MMPH. Pa u nxjerr ligji për ndërtimet pa leje nuk do të kemi rezultate edhe në këto toka bujqësore. Ai në vazhdim sqaroi edhe për disa çështje me disa projekte tjera të parapara.

Naser Rugova falënderoi dhe u bashkëngjiti me konstatimin se plani hapësinor i pa hartuar gjithashtu paraqet problem në këtë drejtim, ndërsa për të ardhmen apeloj për një angazhim serioz ngase është formuar opinioni se Bujqësia nuk ka fare rëndësi dhe askush nuk po mirëton me te. Ai tha se Kosova në BE mund të konkurroi vetëm me bujqësi, mjedis dhe turizëm, ndaj edhe premtoi ministrit Vehapi një **mbështetje blanko** të komisionit sa i përket MBPZHR.

Berat Luzha fillimisht tha se datat e projekteve në strategjinë legjislativë të ministrisë së bujqësisë janë vështirë të realizueshme për çka apeloj të kenë kujdes në ministri, pastaj kërkoi që Ligji për pyje të hartohet sa më shpejt e jo ashtu si është cekur në strategji-në fund të vitit.

Elhame Hetemi tha se presim angazhim më të madh në ministri për projektligjet e propozuara, ndërsa për pyje tha se mjaftojnë ndryshimet e bëra dhe tani të miratuara. Nëse flitet për emergjencë ajo duhet të vlen për projektligjet tjera në agjendën legjislative sidomos për shërbimet këshillimore dhe shpresoi se do të realizohet ngase ministria ka departamentin e veçantë për këtë. Për toka bujqësore kërkoi bashkëpunim të plotë me MMPH sepse duhen të bëhen riparimet e duhura.

Naser Rugova tha se pyjet janë në rend dite pas seancës së kësaj jave ngase sot komisioni jap vizën për leximin e dytë të ndryshimeve në ligjin për Pyje. Ai përsëriti konstatimin se Ligji ekzistues i pyjeve nuk është edhe aq i keq por faji është në organet e ndjekjes, ai nuk kundërshtoi hartimin e ligjit të ri por apeloj për konsultime me mekanizmat tjerë relevant dhe bashkëpunim të plotë gjatë hartimit (sidomos me gjyqësorin).

Berat Luzha përsëriti se ligji ekzistues i pyjeve nuk i ka kriteret e duhura, ka mangësi të shumta të cilat kanë sjellë gjendjen ekzistuese, apeloj që ligji i ri duhet të miratohet deri në fund të 2010-tës.

Ministri **Vehapi** mbrojti qëndrimin se faji është tek mekanizmat e sistemit gjyqësor ngase prej 9000 lëndëve që inspektohen vetëm 2000 kryhen e nuk dihet kur ekzekutohen, megjithatë premtoi se do të vazhdohet me shpejtimin e hartimit të ligjit për ta dërguar në parlament sa më shpejt. Për tokat bujqësore tha se ekziston ligji por ai nuk është për tokë ndërtimore, gjithashtu mungon plani hapësinor. Për këtë arsye kërkohet funksionimi i Gjykatave dhe kujdesi i komunave për tokat e tyre, përndryshe ngelin problemet e përbashkëta.

Naser Rugova falënderoi dhe përshëndeti ministrin deri në takimin në fund të marsit.

4. Vërejtjet e komisionit për buxhet në dy projektligje

- pyjet – procedohet për leximin e dytë (nuk ka vërejtje),
- mbrojtja e ajrit- janë dy amendamente për ndryshimin e shumave të gjobave nga komisioni për buxhet, (u miratuan)
- programet e veçanta- sugjerohet nga komisioni për buxhet të fshihet amendamenti 13 i këtij komisioni, ngase caktimi i cifrës 0.3% shkakton implikime buxhetore shtesë.(u miratua)-**Myrvete Pantina** arsyetoi fshirjen e cifrës së propozuar në këtë komision.
- rrezatimet jonizuese- duhet të fshihet paragrafi 1.4 i nenit 55 ngase përmendet neni 24 e cila është fshi nga komisioni, është konsultuar zyrtari i MMPH (u miratua).

5. Matrica e mbikëqyrjes së ligjeve

Kryetari Naser Rugova ia dha fjalën **Blerim Velës** i cili tha se këtë pasqyrë OSCE ka përgatitur vetëm sa i përket ligjeve mjedisore ku shihet pse nuk kanë ato zbatimin në praktikë.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Të fuqizohet roli mbikëqyrës i Komisionit për Bujqësi dhe Mjedis në ligjet e miratuara në Kuvendin e Kosovës sa i përket fushës së Mjedisit dhe të Bujqësisë.

Kjo do të realizohet duke bërë komisioni presion në dy ministri dhe në opinion për fillimin e zbatimit të monitorimit të ligjeve në këto dy fusha.

Në fund kryetari propozoi shqyrtimin edhe të disa çështjeve :

- **Rekomandimi për seancë** për të tërhequr OMGJ-në sipas kërkesës së ministrit Vehapi (u miratua),

- **Takimi ndërparlamentar** me komisionin homolog të Maqedonisë me 12 shkurt (u caktuan anëtarët e komisionit për atë ditë),
- **Deputetja Elhame Hetemi** ka një ftesë nga komisioni evropian për vizitë më 14 shkurt (u miratua ftesa e bërë nga komisioni evropian në Agjencinë për Ujëra).

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,25. Mbledhja e radhës do të mbahet më 23.2.2010.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova